

Master Plani për Programin e E-Shkollave në Shqipëri

Tabela e Përmbajtjes

Master Plani për Programin e E-Shkollave në Shqipëri	i
Shkurtime	ii
Hyrje	1
Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit dhe Arsimit	1
Situata Aktuale.....	2
Sektori Publik.....	3
Lidershipi	3
Zyra e Kryeministrit.....	3
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	4
Ministritë e Tjera.....	4
Pushteti Vendor.....	4
Angazhimi i Sektorit Privat	4
Partnerët e fushës së TIK	4
Partnerët që nuk janë të fushës së TIK.....	5
Mbështetja e Partnerëve të Zhvillimit.....	5
Një plan veprimi	6
Plani dhe strategjia e përgjithshme	6
Politikat	6
Çështjet Teknike	7
Laboratorët e Kompjuterave dhe Pajisjet.....	7
Rrjetet dhe Lidhja me Internetin	8
Energjia	8
Aplikimet	8
Programet Trajnimesh të Mësuesve dhe Nxënësve	8
Financimi i shpenzimeve kapitale: programi adopto-një-shkollë.....	8
Financimi i shpenzimeve operacionale: kapaciteti i gjenerimit të të ardhurave.....	9
Zbatimi	9
Plani i Punës, një përfaqje me etapa	12
Monitorimi dhe Treguesit	13
Fushata e Marrëdhënieve me Publikun.....	13
Konkluzion.....	13

Shkurtime

CTA	- Këshilltar Teknik Ndërkombëtar
ECDL	- Patenta Evropiane e Kompjuterit
QSH	- Qeveria Shqiptare
ICDL	- Patenta Ndërkombëtare e Kompjuterit
TIK	- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TIKZH	- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit për Zhvillim
ISP	- Ofrues i Shërbimit të Internetit
TI	- Teknologjia e Informacionit
MASH	- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MM	- Memorandum Mirëkuptimi
KM	- Kryeministri
PPP	- Partnerite Publiko-Private
TF	- Task Forca
PNUD	- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	- Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara
UPS	- Furnizues i Perkohshëm Energjie
USAID	- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
BB	- Banka Botërore
GP	- Grupi i Punës

Hyrje

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit dhe Arsimit

Zyra e Kryeministrit të Qeverisë Shqiptare, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës janë përkushtuar për të ofruar standarte të cilësisë së lartë dhe mundësi më të mëdha në fushën e arsimit për nxënësit shqiptarë. Arsimit konsiderohet në mbarë botën si çelësi për nxitjen e rritjes ekonomike dhe lehtësimin e varfërisë si në nivel vendor ashtu edhe në nivel kombëtar. Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit janë veçanërisht të rëndësishme në shtetet ku segmente të popullsisë kanë disavantazhe në arsimim apo jetojnë në zona rurale, siç është edhe rasti i Shqipërisë. Për të rinjtë arsimimi rrit mundësitë e punësimit dhe përmirëson kushtet e tyre sociale-ekonomike. Në një botë që sa vjen e më shumë po orientohet drejt teknologjisë dhe globalizimit, kuptimi, përdorimi dhe krijimi i kulturës së Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është bërë një faktor shumë i rëndësishëm që mundëson arsimimin e nxënësve me një edukim më bashkohor dhe realist, ç'ka nga ana tjetër siguron forca pune me aftësi të përvetësuara të gatshme për tu përballur me sfidat e zhvillimit.

Qëllimi kryesor i Programit të E-shkollave është të mundësojë lidhjen me Internetin të të gjitha shkollave publike nëntë vjeçare dhe të mesme, t'i pajisë ato me laboratorë kompjuterash, si dhe të trajtojë mësuesit për t'i menaxhuar ato dhe për të dhënë mësim me një kurrikulum bashkohor. Ky Program adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë hendekun në marrjen e informacionit në arsimin nëntë vjeçar dhe atë të mesëm, si dhe mbështet nxënësit e sotëm, qytetarët e të nesërme për të përvetësuar aftësitë bashkohore të teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Gjithashtu ky program krijon një mjedis nëpërmjet të cilit nxënësit, pavarësisht nga vendndodhja e tyre në zona rurale apo urbane, mund të kenë akses në TIK, si edhe ofron mbështetje për kurrikulat kombëtare të shkollave nëpërmjet trajnimeve në aftësitë e kërkuara nga tregu aktual i punës. Për të mbështetur këtë program është nënshkruar një Memorandum Mirekuptimi me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për të asistuar në menaxhimin teknik të tij.

Duke iu përgjigjur nevojave të komunitetit dhe aspiratave kombëtare, programi gjithashtu hap dyert për mundësi të tjera zhvillimi që TIK i ofron komuniteteve, duke i lidhur ata me sektorin privat, shërbimet sociale si dhe tregjet, ndërkohë që i ofron dhe përforcon informacionin rreth një sërë çështjesh të lidhura me zhvillimin e vendit. Për këtë arsye, Programi i E-shkollave do të mobilizojnë partneritetet dhe burimet duke ndjekur një model i cili do të krijojë të ardhura dhe kapacitet drejtues në mbështetje të laboratorëve nëpër shkolla.

Për rrjedhojë, Programi i E-shkollat ka në qendër zhvillimin dhe do të mbështesë drejtpërsëdrejti aspiratat e Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Evropian, jo vetëm duke siguruar standarte të larta arsimore por gjithashtu edhe nëpërmjet mundësive që teknologjitë e komunikimit si p.sh. Interneti ju ofrojnë individëve, si për shëmbull mësuesve, nxënësve dhe pjesës tjetër të popullsisë, si dhe t'i ofrojë atyre njohuri dhe mundësi sociale e ekonomike përtej asaj që është e disponueshme në mjediset e tyre. E-

shkollat do të mundësojë përvetësimin e aftësive shumë të nevojshme për sektorë të ndryshëm që nga korporatat e deri në qeveri, që nga tregtia e deri në investime, etj. Ky moment përbën thelbin i krijimit të një Shoqërie të Informacionit e parashikuar në Strategjinë Kombëtare të TIK, tashmë e formuluar nga qeveria.

Situata Aktuale

Në Shqipëri, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka nën juridiksion mbi 2,125 shkollat ekzistuese, ndërkohë që pushteti lokal ka juridiksion në menaxhimin e secilës shkollë. Sistemi shkollor ndahet në 1749 shkolla nëntë vjeçare dhe 376 shkolla të mesme. Shkollat e mesme ndahen në disa kategori funksionale, përfshi këtu Shkollat e Mesme të Përgjithshme, Shkollat e Mesme Teknike, Shkollat e Mesme Sociale – Kulturore, etj. Në disa shkolla, sistemi nëntë vjeçar dhe ai i mesëm janë të kombinuar në një godinë të vetme.

Janë afërsisht 138,428 nxënës dhe 7,780 mësues në sistemin e shkollave të mesme, si dhe 450,582 nxënës e 25,556 mësues në sistemin nëntë vjeçar. Qytetet me më shumë shkolla janë Tirana, Shkodra, Elbasani, Vlora dhe Fieri. Parë nga këndvështrimi arsimor, vetëm më pak së një e treta e shkollave të mesme në Shqipëri kanë nisur procesin e kompjuterizimit. Falë përpjekjeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Cooperazione Italiana rreth 110 shkolla të mesme janë llogaritur të pajisen me kompjutera deri në fund të semestrit të dytë të 2006. Zyra e Cooperazione Italiana në Shqipëri ka financuar pajisje kompjuterike dhe shërbim Interneti për 30 shkolla të mesme në të gjithë vendin për laboratorët e kompjuterave për fazën e parë. Si pjesë e këtij programi, në fazën e dytë pritet që dhe 30-50 shkolla të tjera të mesme të pajisen me laboratorë kompjuterash dhe shërbim Interneti gjatë vitit 2006. Ka filluar trajnimi i 140 mësuesve të informatikës dhe në fazën e dytë do të ofrohet trajnim për mësuesit e informatikës në këto shkolla. Sistemi i trajnimit do të kryhet në formë kaskade ku pritet të trajnohen rreth 1200 mësues. Përveç kësaj, edhe 34 shkolla të të mesme të përgjithshme dhe profesionale, janë plotësuar me laboratorë kompjuterash, kjo si pjesë e investimit të bërë nga vetë Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Me buxhetin e parashikuar, gjatë vitit 2006, pritet të pajisen dhe 30 – 50 shkolla të tjera të mesme.

Gjithsesi, kapaciteti arsimor i shkollave në Shqipëri mbetet i ulët duke qenë se pak mësues janë trajnuar për të dhënë mësim për kompjuterin dhe deri më sot nuk ka akoma një kurrikula të plotë për TIK. Sistemi shkollor nëntë vjeçar nuk kryen mësim kompjuteri dhe për rrjedhojë nuk ka mësues të trajnuar për ta bërë këtë. Në Shqipëri, kompjuteri mësohet zakonisht nëpërmjet qendrave mësimore të kompanive private. Nxënësit kur largohen nga sistemi shkollor nuk kanë përfituar nga teknologjia dhe aplikimet kompjuterike, duke humbur kështu shumë vite të cmuara në edukimin dhe formimin e aftësive të tyre të cilat janë kaq të rëndësishme për të garantuar një punë të mirë në jetë. Ky program adreson këtë hendek arsimor duke krijuar mjedisin e TIK, pasi Shqipëria duhet të trajnojë qytetarët e saj të së ardhmes.

Ka dy probleme të tjera të rëndësishme që lidhen me efektivitetin e përdorimit të TIK në proceset mësimore në shkolla, por që nuk mbulohen nga ky Master Plan. E para lidhet me krijimin e një përmbajtjeje dixhitale të përshtatshme në gjithë formatet e mundshme duke filluar me direktoritë e thjeshta me lidhje faqesh elektronike shkencore-edukative në Internet. E dyta ka të bëjë me krijimin e Rrjetit Shqiptarë për Edukim dhe Kërkim që do ndërlihte gjithë universitetet dhe qëndrat kërkimore.

Sektori Publik

Lidershipi

Përkushtimi më i madh ndaj zhvillimit ka me vete edhe përgjegjshmërinë e rëndësishme të vendim-marrësve për të siguruar që burimet e përcaktuara dhe përpjekjet e bëra të kenë një efekt sa më të madh. Në Shqipëri ky përkushtim i nivelit të lartë si dhe vullneti politik ekzistojnë për të siguruar sukses dhe vetë Kryeministri drejton këtë përpjekje të rëndësishme. Dhe në këtë pikë, përkushtimi i nivelit më të lartë është c'ka siguron sukses. Në rastin e arsimit kjo është edhe më e theksuar. Arsimi është një investim afatgjatë në kapacitetin e nxënëve në mënyrë që ata të bëhen qytetarë produktivë në jetën e tyre të mëvonshme. Ndërkohë që sot TIK është celësi kryesor për të hapur dyert e vlerave të shtuara në produktivitetin e një individi, investimi në arsim recuperohet në mënyrë jo të drejperdrejtë dhe në një hark kohor nga pesë deri në dhjetë vjet. Për rrjedhojë, lidershipi dhe vizioni afatgjatë duhet të jenë prezentë për një kohë të gjatë përgjatë një analize strategjike rreth mënyrave se si nxënësit që kanë përvetësuar TIK mund të integrohen më vonë në punë. Kjo përfshin mundësitë e tregut dhe një mjedis me politika sociale e mundësuese që përfiton plotësisht nga një krah pune më shumë i shkolluar.

Zyra e Kryeministrit

Qeveria Shqiptare (QSH) ka përcaktuar si një nga prioritetet kryesore të saj përmirësimin e sistemit shkollor në vend. QSH synon të modernizojë sistemin arsimor dhe ta bëjë atë më efikas dhe produktiv për tregun dhe për vendin. Një pjesë shumë e rëndësishme e programit të Qeverisë për sistemin arsimor është kompjuterizimi i të gjithë shkollave nëntë vjeçare dhe të mesme në vend. Zyra e Kryeministrit ka marrë një rol kryesues që në ditët e para në nisjen, nxitjen dhe fillimin e këtij programi. Vetë Kryeministri është përfshirë në disa diskutime me aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mobilizimin e mbështetjes së nevojshme për realizimin e programit. Kryeministri ka lëshuar gjatë gjysmës së parë të muajit nëntor një urdhër për “Krijimin e një Grupi Pune ndër Institucional për Përgatitjen e Master Planit për Zgjerimin e TIK në të gjithë Sistemin Shkollor”. Ky Grup Pune përbëhet nga 14 ekspertë nga ministritë kryesore, ekspertë nga organizata ndërkombëtare, shoqëria civile dhe akademike. Ky grup pune kryesohet nga Zëvendës Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe mbledhet rregullisht për përgatitjen e versionit final të Master Planit dhe për të këshilluar dhe mbikqyrur zbatimin e tij.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Minsitria e Arsimit dhe Shkencës, duke qenë se ka peshën kryesore në këtë nismë, është përcaktuar për të drejtuar programin dhe për të asistuar aktivitetet e tij në aspektet teknike e financiare. Minsitria tashmë ka krijuar:

- Sipas urdhrit të Kryeministrit, një grup pune me pjesëmarrje të gjerë nga qeveria, akademia, shoqëria civile dhe komuniteti i donatorëve, me qëllim përgatitjen e këtij master plani dhe;
- Një task forcë të brendshme për shqyrtimin, rishikimin dhe përmirësimin e kurrikulës aktuale për mësimdhënien e informatikës në të gjitha shkollat e mesme si dhe për të krijuar kurrikulumin për arsimin e detyruar.

Përfshirja e Ministrisë për kompjuterizimin e të gjitha shkollave shprehet gjithashtu në terma financiarë duke alokuar një shumë të konsiderueshme për këtë iniciativë. Ministria ka plane konkrete për reformimin e institucioneve të saj të trajnimit dhe për vënien e tyre në punë në mënyrë më efektive për të trajnuar mësuesit për teknologjitë kompjuterike.

Ministritë e Tjera

Ministritë e tjera që do të përfitojnë në mënyrë indirekte nga rezultatet e këtij programi dhe që duhet gjithashtu të përfshihen në të për një zbatim të suksesshëm janë: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punë, Cështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta dhe Ministria e Brendshme. Bashkëpunimi dhe konsultimi i ministrive të sipër përmendura janë shumë të rëndësishme për suksesin e programit.

Pushteti Vendor

Roli i pushtetit vendor është i një rëndësie shumë të madhe në procesin e zbatimit dhe vecanërisht në krijimin e një mjedisi mbështetës dhe të qëndrueshëm për të ardhmen për gjithë investimin që do të bëhet në shkollat nëntë vjeçare dhe të mesme. Është e nevojshme që gjatë çdo hapi të zbatimit të këtij programi të ketë një bashkëpunim dhe partneritet të ngushtë me Ministrinë e Brendshme, nën të cilën qëndron dhe ish Ministria e Pushtetit Vendor. Një përfaqësues i kësaj Ministrie merr pjesë në Grupin e Punës dhe ofron asistencën e tij si dhe vë qëllimet e kësaj nisme në një linjë me ato të ministrisë.

Angazhimi i Sektorit Privat

Partnerët e fushës së TIK

Përfshirja dhe angazhimi i sektorit privat është një pikë kyçe në realizimin dhe qëndrueshmërinë e programit. Nga takime dhe bisedime paraprake që janë bërë me pjesë të ndryshme të sektorit privat është siguruar mbështetje në forma të ndryshme.

Kompanitë më të mëdha në vend në tregun e pajisve kompjuterike kanë ofruar cmime të reduktura për këtë program për pajisjet që tregtojnë. E rëndësishme është edhe gadishmëria që kanë treguar ISP-te (kompani që ofrojnë shërbim Interneti) kryesore në vend për të kontribuar me infrastrukturën dhe ekspertizën e tyre.

Menaxheret e Internet kafeve dhe pronarët e tyre mund të bëhen partnerë aktivë të biznesit për mirëmbajtjen dhe funksionimin e laboratorëve të kompjuterave për nevoja të komunitetit pas përfundimit të mësimit. Ata kanë ekspertizën e mbledhur gjatë këtyre viteve për të drejtuar laboratorë të tillë dhe për të gjeneruar të ardhura nga to. Nga një studim i shpejtë i bërë me Internet Kafetë në Tiranë, është parë një dëshirë e madhe për të mbështetur programin si dhe shumë interes për t'u përfshirë në funksionimin e laboratorëve të kompjuterave pas përfundimit të mësimit. Ky lloj partneriteti mund të konsiderohet si një mekanizëm shumë i fuqishëm për qëndrueshmërinë e investimit të bërë nga programi.

Partnerët që nuk janë të fushës së TIK

Bankat kanë shprehur interes të madh për tu bërë partnerë të këtij programi. Madje ka banka që kanë shprehur gadishmëri në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për të financuar laboratorë kompjuterash për disa shkolla të ndryshme të vendit.

Interesi i shprehur nga bankat lidhet me faktin që laboratorët e kompjuterave mund t'i shërbejnë komunitetit dhe bankave përmes rrjetit të shkollave në të gjithë vendin mund të zgjerojnë shërbimin e veprimeve bankare elektronike të cilat mund të aksesohen nga më shumë klientë. Bankat janë të gatshme të mbështesin aktivitetet komunikuese dhe ndërgjegjësuese si dhe të kontribuojë për botimin e manualeve dhe materialeve promocionale.

Mbështetja e Partnerëve të Zhvillimit

Mbështetja e partnerëve të zhvillimit për sektorin e arsimit ka qënë prezente në Shqipëri menjëherë pas ndryshimeve sociale e politike në vitin 1990. Përsa i përket çështjeve që kanë lidhje me TIK, pothuajse asnjë projekt/ndërhyrje nuk i ka vendosur ato si objektiva kryesore. Çështje të tilla janë adresuar zakonisht si elementë të projekteve të ndryshme.

Disa organizata ndërkombëtare janë përfshirë edhe më parë në programe për trajnimet e mësuesve dhe zhvillimin e përmirësimit të kurrikulave bashkëkohore. Organizatat ndërkombëtare, agjencitë e ndryshme të zhvillimit dhe organizata të tjera jo-qeveritare zotërojnë përvoja të ndryshme në mbështetjen e sektorit arsimor në të kaluarën dhe përfshirja e tyre do të këtë shumë peshë në suksesin e këtij programi.

Një plan veprimi

Plani dhe strategjia e përgjithshme

Nëpërmjet një përjasje të integruar menaxhimi efikas dhe transparent të prokurimeve dhe kapaciteteve, programi do të fillojë menjëherë të pajisi shkollat me laboratorë kompjuterash dhe lidhje me Internetin. Si hap i parë që përfshin periudhën deri në fund të 2006, pritet rreth 65% -75% nxënës të shkollave të mesme dhe 5% -10% nxënës të shkollave nëntë vjeçare të kenë mundësi për të ndërvepruar me TIK. Përqindja e nxënësve që do të kenë akses në TIK do të rritet në së paku 90% në shkollat e mesme dhe 40% - 50% në shkollat nëntë vjeçare gjatë vitit 2007, dhe pjesa e mbetur do të kompletohet deri në fund të vitit 2008. Që kjo të bëhet realitet do të përdoret master plani i mëposhtëm i dhënë në vija të përgjithshme:

1. QSH do të mbështetet tek ekspertiza dhe asistenca e rrjetit të partnerëve të zhvillimit duke përfshirë këtu organizatat ndërkombëtare si për shembull Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, me të cilën është nënshkruar tashme një MM, komunitetin e donatorëve, akademinë, shoqërinë civile dhe sektorin privat, për të mbështetur vizionin e Kryeministrit dhe për t'a bërë atë realitet në favor të interesave kombëtare;
2. Brenda një muaji do të krijohet një njësi zbatuese për të menaxhuar projektin nën mbikqyrjen nga afër të MASH. Ky ekip do të përfshijë një Drejtor Projekti, një Këshilltar Teknik Ndërkombëtar si dhe stafin kombëtar sipas nevojave;
3. Prokurimi i pajisjeve do të fillojë menjëherë në vitin 2006 dhe do të vazhdojë përgjatë viteve në vazhdim me mbështetje nga PNUD-i; Sponsorizimet nga donatorët dhe partnerët pritet që të garantojnë koston e veprimeve;
4. Duke marrë parasysh implikimet financiare të qëndrueshmërisë afatgjatë të programit, do të vlerësohet një model i cili do të mundësojë shkollat të gjenerojnë të ardhura nga funksionimi i laboratorëve të kompjuterave pas orarit mësimor, ashtu si është bërë në mënyrë të suksesshme edhe në vende të tjera. Kjo do të përfshijë një sërë politikash dhe kushtesh të shprehura në pjesën e politikave si më poshtë.

Politikat

Në mënyrë që E-shkollat të bëhen realitet duhet të hartohen politika dhe udhëzime (akte, urdhëra, dekrete, etj) qeveritare të cilat krijojnë një mjedis të qëndrueshëm brenda sistemeve arsimore në mënyrë që shkollat të vetë-financohen. Qeveria do të shikojë mundësinë për të inkurajuar dhe lehtësuar biznesin privat për tu bërë pjesë e këtij programi. Këto udhëzues do të vihen në zbatim nëpërmjet një Task Force (shih më poshtë në këtë dokument):

A) Vendorsja e objektivave arsimore të TIK në shkolla;

1. Trajnimi i mësuesve dhe trajnuesve për bazat e TIK, përdorimin e kompjuterave dhe aplikimeve, teknikat bazë të Internetit, bazën e zgjidhjes së problemeve.

2. Përvetësimi me metodologjinë mësimore të TIK, të cilat mundësojnë që mësuesit dhe nxënësit të përmirësojnë procesin mësimor.
 3. Krijimi i një mjedisi shkollor interaktiv nëpërmjet aplikimeve të TIK në menaxhimin e shkollave dhe krijimit të lidhjes midis palëve në shkollë, më konkretisht drejtuesve, mësuesve, nxënësve dhe prindërve.
 4. Prezantimi i një niveli mësimor të TIK i cili do të bëjë të mundur që nxënësit deri në fund të shkollës së mesme të kualifikohen në programe certifikimi si Patenta Evropiane e Kompjuterit (ECDL), MOUS, IC3 e të tjerë. Përsa i përket trajnimit për TIK, keto nivele duhet të konsiderohet si nivele baze i kualifikimit. Procesi i certifikimit në programe e lartë-përmendura në fund të shkollës së mesme rrit shumë shanset që nxënësit kanë për tu punësuar më lehtë, në momentin që ata vendosin të mos vazhdojnë më tej studimet, apo të jenë më mirë të përgatitur për të ndjekur kurset e arsimit të lartë.
 5. Përgatitja e nxënësve dhe komunitetit për punësim në jetën reale, si për shëmbull punë sekretarie, programet bazë, krijimi i faqeve të Internetit, etj.
- B) Vendosja e marrëdhënieve me partnerët e zhvillimit për të mbështetur objektivat e MASH;
 - C) Vendosja e përgjegjësive dhe marrëdhënieve në ministritë e linjës të cilat janë të angazhuara me programin, duke përfshirë këtu mbështetjen, subvencionet, etj;
 - D) Mbështetja e menaxhimi i laboratorëve kompjuterik nga shkollat apo ndërmarrjet lokale, gjenerimi i të ardhurave, etj;
 - E) Vendosja e standarteve për pajisjet, rrjetat dhe aplikimet;
 - F) Vendosja e pikave të referimit dhe treguesve për monitorimin dhe rivendosjen në linjë të programit;
 - G) Vendosja e prioriteteve financiare dhe shpenzimeve të buxhetit.

Çështjet Teknike

Laboratorët e Kompjuterave dhe Pajisjet

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nëpërmjet partnerëve të saj, do të përgatisë dhe përmirësojë modelin bazë për pajisjen e shkollave me kompjutera. Kjo do të përfshijë një numër kompjuterash për çdo shkollë të mesme dhe nëntë vjecare, të organizuar në një laborator kompjuterash me rrjet dhe lidhje Interneti. Madhësia e laboratorëve do të jetë në varësi të numrit të nxënësve për çdo shkollë. Ky plan nuk do të merret me specifikimet dhe standartet teknike, por do të tregohet kujdes që pajisjet e instaluar në shkollat të jenë të përdorshme dhe të përmirësueshme në linjë me standartet aktuale ndërkombëtare. Ngritja e laboratorëve në shkollat duhet të favorizojë kompjuterat dhe pjesët e tjera me konsum të ulët elektrik për të siguruar që ngarkesa totale elektrike është e përshtatshme për vendin ku do të instalohen laboratorët. Atje ku do të jetë e nevojshme, duhet të konsiderohen laptopët apo monitorë LCD.

Rrjetet dhe Lidhja me Internetin

Lidhja me Internetin së bashku me mirëmbajtjen e kompjuterave përbën një prej kostove operacionale më të larta të programit. Për këtë arsye, lidhja me Internetin do të vlerësohet me kujdes ose si një blerje në sasi të mëdha nga një apo më shumë ofrues, ose, nëse është e përshtatshme financiarisht, si zbatimi i një rrjeti të dedikuar të një sistemi shkollor. Lidhja me Internetin mund të ofrohet nëpërmjet lidhjeve fikse ose ato pa tel. Në zonat ku kjo nuk është e mundur duhet të konsiderohen lidhjet nëpërmjet telefonit, ose nëse kostot ulen nga volumi i blerjeve, nëpërmjet lidhjeve satelitore.

Energjia

Për shkak të kufizimeve aktuale të energjisë në disa zona në Shqipëri, do të tregohet kujdes për të siguruar sisteme mbështetëse të bazuara në Furnizues të Pandërprerë të Energjisë (UPS) apo bateri e inverter. Do të konsiderohet sipas nevojës edhe pajisja me gjeneratorë.

Aplikimet

Çdo rrjet në shkollë do të pajiset me aplikacione open source (aplikacione falas) ose komerciale, përfshi këtu programet për përpunimin e tekstit, aplikimet e vizatimit, etj, si dhe aplikimet e Internetit përfshi këtu browser-at dhe postën elektronike.

Programet Trajnimesh të Mësuesve dhe Nxënësve

Programi mësimor i ECDL apo certifikimeve të tjera për trajnimet bazë, të avancuara dhe specifikë për trajnimin e mësuesve jepen në një dokument të veçantë.

Financimi i shpenzimeve kapitale: programi adopto-një-shkollë

Ndërmarrja e një fushatë efektive të mbledhjes së burimeve për të siguruar mbështetje për shpenzimet kapitale për zgjerimin e laboratorëve për shkolla shtesë përtej periudhës fillestare të zbatimit është tepër e rëndësishme. Fushata e mbledhjes së burimeve do të bashkojë mbështetës nga komuniteti i donatorëve, qeveria, sektori privat, institucionet financiare dhe shoqëria civile. Kjo mbështetje do të synojë të bashkë-financojë shpenzimet që lidhen me zgjerimin e laboratorëve të kompjuterave.

Në mënyrë për të siguruar fonde për buxhetin e mësipërm, partnerët e zhvillimit, donatorët, kompanitë dhe individitët ftohen që të adoptojnë një ose më shumë shkolla. Paketat e adoptimit do të bazohen mbi tipin e shkollës së mbështetur dhe do të përfshijnë kostot administrative deri në masën 6%. Paketat do të përfshijnë pajisjet, lidhjen dhe mirëmbajtjen për tre vjet, trajnimin e trajnerëve, furnizimin me energji, etj. Paketa bazë e adoptimit të shkollës do të jetë:

Për Laboratorët me 15 kompjutera afërsisht: \$ 15,000

Për Laboratorët me 7 kompjutera afërsisht: \$ 8,000

Paketa mund të adoptohet edhe e pjesshme.

Pritet që donatorëve të mëdhenj si ata publik ashtu edhe privat të kontribuojnë në një masë thelbësore për këtë program, emrat dhe kontribuimi i tyre bujar do të shpalosen në

secilin kompjuter nëse ata dëshirojnë kështu. Mbështetësit e programit mund gjithashtu të zgjedhin shkolla në zona gjeografike specifike dhe do të ftohen që t'i vizitojnë ato.

Financimi i shpenzimeve operacionale: kapaciteti i gjenerimit të të ardhurave

Shpenzimet operacionale të nënvijëzuara në buxhet janë detyrimet financiare afatgjata të programit. Duke qënë se ato do të mbështeten për një periudhë të gjatë kohe, praktikisht përgjithmonë, ato duhet të trajtohen në një mënyrë të përshtatshme. Duke marrë mësim nga eksperiencat e suksesshme në vende të tjera, është parë se hapja e laboratorëve të shkollave për publikun pas orarit të shkollës dhe gjatë fundjavave kur shkolla nuk është hapur, ka potencialin për të gjeneruar të ardhura të mjaftueshëm për të mbështetur funksionimin e laboratorëve. Kjo mundësi do të ketë nevojë për disa ndryshime në politikat dhe rregulloret e shkollës duke përfshirë:

- a. Me qëllim krijimin e një modeli pune dhe plani biznesi, dhënien e lejes për një numër fillestar shkollash për të operuar laboratorët e kompjuterave komercialisht, me kusht që të mos ketë asnjë interferencë me aktivitetet normale të shkollës. Kjo do të bëhet nëpërmjet një urdhëri të veçantë në fillim, dhe më pas do të zgjerohet nëpërmjet një politike pune të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për shkollat që ngelen.
- b. Nëpërmjet autoritetit shkollor drejtpërsëdrejti në secilin lokalitet apo nëpërmjet kompanive private dhe biznesmenëve individualë, sipas një marrëveshjeje veprimi e cila do të përshkruajë kushtet dhe modalitetet, të lejohen laboratorët e shkollave të jenë të hapur për përdorim publik. Kushtet do të përfshijnë:
 - i. Menaxhimin e operimit të laboratorëve të shkollave: Orët e veprimtarisë, çmimet maksimale, faqet dhe aplikimet e lejuara;
 - ii. Mirëmbajtjen e sistemit, përfshirë mirëmbajtjen rutinë, përditësimet e sistemit, përditësimin e aplikimeve, mirëmbajtjen e rrjeteve, etj.
 - iii. Pagesën e shpenzimeve operacionale në lidhje më të mësipërmet dhe duke përfshirë lidhjen me Internetin;
 - iv. Pagesën e kuotave shkollore për përdorimin komercial të laboratorëve të shkollës, nëse kjo është e aplikueshme;
 - v. Trajnimi dhe të ardhurat nga kurset e ofruara publikut, duke përfshirë përgatitjen për ICDL dhe programe të tjera certifikimi.
 - vi. Përdorimi i të ardhurave nga shërbime të tjera, si psh. përdorimi i aksesoreve periferikë (printerat, skanera), dhe shërbimeve të komunikimit (faks, telefon), etj;
 - vii. Modalitetet për tu kualifikuar si një Qendër e Shpërndarjes së Internetit. Procesi i kualifikimit dhe seleksionimit.

Zbatimi

Task Forca

Programi Shqiptar i E-shkollës do të zbatohet nëpërmjet Master Planit të tij, i cili do të mbulojë tre vjetë gjatë periudhës 2006-2008. Plani do të rishikohet çdo vit dhe do të përditësohet nëpërmjet planeve të punës.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) do të jetë njësi e ngarkuar nga qeveria me përgjegjësinë për zbatimin e planit duke përfshirë marrëdhëniet me qytetarët, botën akademike, sektorin privat, dhe komunitetin ndërkombëtar rreth çështjeve që dalin prej këtij plani. Një faqe Internet do të krijohet për të informuar publikun e gjerë rreth zbatimit të planit.

PNUD-i do të paraqesë asistencën teknike dhe burimet njerëzore të nevojshme për zbatimin e planit. PNUD do të mbështesë gjithashtu me kapacitete logjistike sipas nevojave.

Ndërsa qeveria – e përfaqësuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës – do të jetë plotësisht përgjegjëse për zbatimin e planit dhe do të angazhojë dhe bashkëpunojë me gjithë të interesuarit kryesorë për të siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri. Për të pasur kontroll të plotë për natyrën shumë-sektoriale dhe shumë-dimensionale të iniciativës, do të krijohet një task force për

- (a) të mbikqyrur progresin e përgjithshëm të zbatimit, dhe
- (b) për të paraqitur një platformë për konsultimin me shoqërinë.

Termet e Referencës së kësaj Task Force mund të përfshijnë sa më poshtë:

1. Të sigurohet mbështetja e plotë kombëtare duke përfshirë të gjithë të interesuarit kryesorë dhe aktorë të tjerë të gatshëm për të kontribuar në program;
2. Inicimin e partneriteteve;
3. Mbështetjen dhe mobilizimin e burimeve;
4. Sigurimin e transparencës dhe objektivitetit;
5. Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nëse është e nevojshme;
6. Këshillimin dhe aprovimin e planeve dy-vjeçare të punës.

Task Forca do të kryesohet nga Ministri/Zëvendësministri i MASH. Antarët e Task-Forcës do të zgjidhen nga agjensitë qeveritare, organizatat publike dhe private, duke përfshirë OJF-të, shoqatat e profesionistëve, kompanitë e sektorit privat, organizatat ndërkombëtare, donatorët bilateralë etj. Individët e shquar, lokalë dhe të huaj, mundet gjithashtu të jenë anëtarë të Task-Forcës sipas vendimit të MASH. Task-Forca do të mbledhet çdo katër muaj ose kur të jetë e nevojshme.

Siç u përmend më lart, Task Forca do të krijojë një platformë të përbashkët partneriteti për të gjithë të interesuarit nën lidhshirë dhe drejtimin e qeverisë. Gjatë tre viteve të para të operimit do të mbështetet nga PNUD dhe të tjerë partnerë zhvillimi për të përmbushur qëllimin e vet parësor – për të lidhur shkollat me Internetin, për t'a përdorur efektivisht atë dhe të tjera mjete dixhitale në proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe për ta zgjeruar lidhjen me Internetin drejt komunitetit të gjerë nëpërmjet partneriteteve të biznesit.

Po ashtu, një tjetër objektiv i rëndësishëm i Task-Forcës do të jetë zhvillimi i një modeli të qëndrueshëm operacional dhe organizativ që do të jetë në gjendje të vazhdojë punën kur mbështetja e jashtme të përfundojë apo të ulet ndjeshëm. Qëndrueshmëria mund të sigurohet:

- Duke adresuar nevojat dhe kërkesat vazhdimisht në rritje që shkollat dhe komunitetet lokale kanë për përdorimin e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për mësim e zhvillim;
- Duke aplikuar një model të mundshëm dhe tërheqës për të gjitha partneritetet e biznesit, si psh. adoptimet e shkollave individuale apo të grupeve të shkollave;
- Duke rritur aktivitetet përtej lidhjes me Internet dhe pajisjeve, gjeografikisht dhe tematikisht; dhe
- Duke zhvilluar dhe testuar modele organizativë qeverisjeje efektive, transparente, dhe të përgjegjshme të programit të E-shkollës në një perspektivë afatgjatë.

Eksperiencia e vendeve të avancuara në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit demonstroi se iniciativa të tilla të E-shkollës tentojnë të vazhdojnë dhe zakonisht duke zgjeruar objektivat dhe afatet kohore të vendosura në fillim. Sidoqoftë, kjo kërkon nivel të caktuar institucionalizimi të programit përtej komponentëve të pronësisë dhe menaxhimit qeveritar.

Ndërsa roli i qeverisë në përkufizimin e politikave kombëtare do të ngelet i pazëvendësueshëm, praktikat e menaxhimit të brendshëm dhe arranzhimet që rregullojnë procesin e zbatimit nëpërmjet partneriteteve bashkëpunuese mund të delegohen vazhdimisht tek vetë të interesuarit të cilët do të bien dakort për një formë të caktuar institucionalizimi organizativ.

Në këtë aspekt Task Forca në tre vitet e para do të eksplorojë dhe gjejë modelin më mirë të punës që është i aftë të japë rezultatet e dëshiruara dhe në të njëjtën kohë të jetë në gjendje nga ana organizative dhe manaxheriale për të mbajtur veten.

Do të jetë e pritshme që, në fund, Task Forca të mund të transformohet në një institucion që do të ketë statusin ligjor më të përshtatshëm të momentit (për shembull, atë të një organizate të tipit jo fitimprurës apo të një ndërmarrjeje sociale) për të vazhduar misionin e E-shkollës nën drejtimin e vazhdueshëm të qeverisë.

Një nga objektivat e PNUD-it dhe partnerëve të tjerë me këtë qëllim do të jetë ndihmesa për të ndërtuar kompetenca të reja dhe praktika menaxhimi bashkëpunues të cilat do të mbështesin punën efektive të Task-Forcës dhe do ta kthejnë atë në një institucion të mirë-menaxhuar, misioni i të cilit do të jetë mbështetja dhe promovimi i një Shoqërie Shqiptare të Informimit për të gjithë.

Plani i Punës, një përfaqje me etapa

Parashikohet që programi të ketë filluar në muajt e parë të vitit 2006. Për këtë do të jenë të nevojshëm hapat e mëposhtëm:

1. Të krijohet Task Forca, si një komitet drejtues, fillimisht me qëllimin për të drejtuar programin nën lidhshkrimin e MASH;
2. Të sigurohet mbështetja financiare fillestare nga donatorët dhe mbështetësit siç u tregua edhe më lart, duke përgatitur dhe ofruar paketat e adoptimit të shkollave;
3. Të krijohet një Njësi e Zbatimit të Programit (MASH, PNUD), me një Këshilltar Teknik Ndërkombëtar të nivelit më të lartë të mundshëm dhe me staf e mbështetje profesionale.
4. Të krijohen udhëzimet dhe standartet teknike për pajisjet e shkollave, lidhjen me internetin, furnizimin me energji, etj.
5. Të krijohen udhëzime për funksionimin e laboratorëve të shkollave, duke përfshirë të ardhurat e sugjeruara, përmbajtjen dhe aplikimet e lejuara, etj.
6. Të krijohen praktika trajnimesh dhe çertifikimesh për mësuesit duke përdorur kurrikulan e ECLD, IC3 apo programeve të tjera;
7. Të krijohet, në bashkëpunim me MASH, një kurrikul bazë për trajnimin e nxënësve, duke përdorur programet e kursit të parapregatitura nga ECLD, IC3 apo programeve të tjera;
8. Zhvillimi i tenderit për marrjen e pajisjeve;
9. Zhvillimi i tenderit për marrjen e linjës së Internetit të ndarë në zona gjeografike për të maksimizuar eficiencën dhe konkurrencën;
10. Zhvillimi i tenderit/tenderave për një grup fillestar shkollash;
11. Dhënia e tenderit/tenderave për linjën Internet në këto shkolla;
12. Supervizimi i instalimit të laboratorëve të shkollave;
13. Në të njëjtën kohë me pikën 7, të publikohet një kërkesë për interesimin dhe ofertat për operimin e laboratorëve të shkollave dhe të mbledhen ofertat e operatorëve.
14. Pasi të jenë krijuar udhëzimet dhe të jenë mbledhur aplikimet fillestare nga operatorët potencialë, të organizohet një konferencë e lançimit operacional për të përshkruar dhe diskutuar programin, kjo konferencë të jetë e hapur për gjithë operatorët dhe furnitorët potencialë.
15. Nëpërmjet MASH, të identifikohet një grup mësuesish për trajnimin fillestar në shkollat e zgjedhura të fazës së parë, të sigurohet pjesëmarrja në një kurs fillestar trajnimi dy javor që do të mbahet në qendrat kryesore provinciale, për këtë gjë, Taks Forca do të marrë në konsideratë opsionin e zbatimit të një Njësie të Lëvizshme Internet, një klasë kompjuteri brenda nje autobuzi apo kamioni që mund të përdoret për të shërbyer çdo pikë të vendit me një trajnim të tillë;
16. Të supervizohet instalimi i kompjuterave në shkollat e zgjedhura të fazës së parë, të aprovet instalimi, të finalizohen marrëveshjet kontraktuale me furnizuesit;
17. Të supervizohet menaxhimi i shkollave nëpërmjet operatorëve të zgjedhur;
18. Të supervizohet trajnimi i mësuesve në pikat e zgjedhura;
19. Të supervizohet shpërndarja e kurrikulës së shkollave tek nxënësit;
20. Të vazhdohet me fazën pasardhëse të zbatimit.

Monitorimi dhe Treguesit

Treguesit për këtë program do të jetë:

1. Përqindja e shkollave të pajisura dhe të lidhura me internet;
2. Përqindja e mësuesve të trajnuar;
3. Përqindja e nxënësve të regjistruar në klasat e kompjuterit;
4. Përqindja e nxënësve të cilët, në fund të kursit, do të fitojnë çertifikatën e ECDL apo ndonjë çertifikatë të ngjashme.

Fushata e Marrëdhënieve me Publikun

Një lançim zyrtar i programit pritet të bëhet në 19 Dhjetor 2005. Në lançimin, që do të mbahet bashkarisht nga MASH dhe PNUD, do të ftohen përfaqësuesit e qeverisë, komunitetit ndërkombëtar, akademisë, sektorit privat, OJF-ve dhe shoqërisë civile. Programi do të hapet nga Kryeministri i Shqipërisë dhe fjalime të rëndësishme pritet të mbahen nga partnerët zbatues. Lançimi do të përshkruaj programin në detaj nëpërmjet një prezantimi. Në lançim do të bëhet një apel për mbështetje dhe do të shpërndahet informacion në lidhje me shkollat që do të adoptohen. Për më tepër, lançimi do të bëjë një apel sektorit privat dhe biznesmenëve dhe do të përshkruaj oportunitetet që do të ofrohet të dy palëve.

Konkluzion

Ky plan dhe kjo thirrje për ndihmë synon të adresojë çështjet kryesore që lidhen me programin. Detajet operacionale dhe institucionale, politikat dhe udhëzimet, standartet dhe kontratat janë jashtë qëllimit të këtij dokumenti dhe do të trajtohen veçan nga Task-Forca. Një Aneks i veçantë me dokumentat mbështetës, si psh. eksperiencat në vende të tjera, modele të të ardhurave, etj. do të përgatitet për Grupin e Punës dhe eventualisht për Task Forcën. Ky dokument do të përgatitet në Shqip dhe Anglisht për komunitetin ndërkombëtar dhe partnerët kombëtar.